

Raport i Likujdatorit te Shoqerise "AAMG" SHPK LIDHUR ME LIKUJDIMIN E SHOQERISE

I. Pranimi i Mandatit te Likujdatorit

Me Vendimin Nr..Prot, date 19.01.2023, te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise "ALBANIAN ASSET MANAGEMENT GROUP" SHPK(AAMG) une Minushe Xhafo jam emeruar Likujdatore e kesaj Shoqerie.

Pranimi i mandatit te Likujdadores eshte kryer sipas Ligjit 9901, date 14.04.2008,"Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe ligjit te Qendres Kombetare te Regjistrimit, Nr.9723, date 03.05.2007. Ne pranimin e mandatit une nuk jam ndodhur ne kushtet e ndonje ndalese ligjore apo papajtueshmerie.

Per permbushjen e misionit u disponua;

- Vendimi i Asamblese se Ortakeve te shoqerise i dates 19/01/2023
- Pasqyrat financiare per periudhen Janar- Dhjetor 2023
- Pasqyrat Financiare per periudhen Janar- Nentor 2024
- Pasqyra e levizjes se Kapitalit

II. Krijimi dhe venia ne likujdim e Shoqerise "AAMG" SHPK (Shoqeri ne likujdim e siper)

- Te dhena te Pergjithshme per Shoqerine.

Shoqeria "ALBANIAN ASSET MANAGEMENT GROUP" SHPK e regjistruar ne QKB me date 23.02.2022 ne baze te ligjit 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit" si edhe legjislacioni tjeter ne fuqi, ligji Nr 9901 date 14.04.2008 "Per Shoqerite Tregtare".


Eshte e regjistruar ne Organet Tatimore me Nr (NUIS) M 21523030 G

Kapitali i Nenshkruar eshte 100 Leke,

Shoqeria eshte themeluar nga Ortaket si me poshte;

1. Z. Hekuran Brahimaj i cili zoteron 60% te kuotave te kapitalit,
2. Z. Sefer Selim Erdem i cili zoteron 30% te kuotave te kapitalit,
3. Z. Fikret Bangu i cili zoteron 10% te kuotave te kapitalit,

Objekti i veprimtarise eshte;



Menaxhimin e investimeve te lidhura me kompanite qe ushtrojne aktivitet ne fushen e bujqesise, Energjetikes, apo ne sektore te tjere qe kane potencial te larte rritjeje. Ne kete kuader, shoqeria ka nje rol aktiv dhe monitorues ne menaxhimin e kompanive ne te cilat jane bere investime. Ofrimin e sherbirneve keshillimore ne sektoret perkates per te ndihmuar qe kompanite ne te cilat eshte investuar, te realizojne potencialin e tyre te plote dhe te arrijne qellimet e tyre financiare afatgjata. Ndermjetesimin dhe lobimin per investime ne sektore te ndryshern te ekonomise me qellim kthimin potencial te investimit dhe realizimin e perfitimeve terheqese ekonomike per periudha afatgjata. Shoqeria mund te kryeje te gjitha operacionet tregtare, industriale, financiare, mobiliare, imobiliare te konsideruara si te nevojshme ose te dobishme per arrijten e objektit te aktivitetit te shoqerise, duke saktësuar se aktiviteti financiar mund te kryhet vetem me qellim realizimin e objektit te shoqerise, Ajo gjithashtu mund te bleje kuota dhe/ose aksione ne shoqeri te tjera. Me qellim realizimin e objektit te aktivitetit te saj, Shoqeria mund te adrninistroje, bleje, shese, te jape me qira si dhe te kete interesa e pjesernarrje ne shoqeri, te themeluara apo ne proces themelimi, qe kane objekt te ngjashem me objektin e aktivitetit te Shoqerise, ose qe i sherben realizimit te ketij objekti. Ne pergjithesi, Shoqeria mund te kryeje cdo veprimtari te nevojshme e te dobishme, te lejuar nga ligji per realizimin e objektit te aktivitetit te saj. Shoqeria mund te ofroje sherbirne te tjera ose te kryeje aktivite te tjera sic vendoset permes vendimeve te Asamblese se Pergjithshme ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Shoqeria mund te ndryshoje objektin e saj te aktivitetit ne cdo kohe, ne perputhje me dispozitat e Ligjit Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare dhe ketij Statuti.

Selia e shoqerise eshte ne Tirane Autostrada Tirane - Vore, Rruga Industriale, Nd.61,1053
Nuk eshte e organizuar ne filiale apo dege.

Organet e Drejtimit

- a. Asambleja
- b. Administratori

Baza Ligjore

Veprimtaria e Entitetit rregullohet me;

-Statut

-Ligji nr,9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare"

-Ligji nr,25/2018 Per Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare

-Akte te tjera ligjore e nenligjore te shtetit shqiptar

Me Vendimin date 19/01/2023, te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise "ALBANIAN ASSET MANAGEMENT GROUP " sh.p.k, Ortaket e saj;

Vendosen te miratojne mbylljen e Shoqerise dhe ç'regjistrimin e saj ne QKB.

Arsyeja e prishjes se Shoqerise eshte me deshiren e Ortakeve te saj, te cilet vendosen te mos ushtrojne aktivitet per arsye objektive pasi nuk ariten te sigurojne kontrata per ushtrimin e ketij aktivitetit per shkak te konkurences se lartese dhe pengesave te tjera te ushtrimit te veprimtaris ne kete fushe.

ANALIZA E POSTEVE TE BILANCITE TE REFORMUAR

Shoqeria nuk ka kryer aktivitet, qe nga krijimi i saj e deri sot por ka shlyer sipas ligjit te gjitha detyrimet ne shtet si dhe ka kryer disa shpenzime minimale per sigurimet shoqerore, Ne bilancin kontabel te reformuar pasqyrohen pake zera apo poste si me poshte;

AKTIVET AFATSHKURTERA

Aktivet Monetare, Gjendja neto ne bilancin e reformuar 270 Leke me strukture

Mjete Monetare ne Banke 0 leke

Mjete Monetare ne Arke 270 leke

Totali i Aktiveve Afatshkurtera 270 Leke

DETYRIMET AFATSHKURTERA

Nuk ka detyrime afatshkurteraper sigurime shoqerore por vetem detyrime ndaj Ortakeve ne shumen 1.044.500 leke

KAPITALI

Gjendja e kapitaleve te veta ne bilanc eshte (1.044.230) leke ,me strukture

Kapitali i nenshkruar 100 leke

Humbja e krijuar - 1.044.330 leke.

Totali i Detyrimeve dhe i Kapitalit 270 leke

. Kjo Shoqeri persa i perket vlerave materiale, monetare dhe detyrimeve, jane si me poshte;

- Nuk ka gjendje te mjeteve kryesore, aktiveve te qendrueshme, te trupezuara ose te patrupezuara.
- Nuk ka gjendje mallrash, materiale apo vlera monetare.
- Nuk rezultojne detyrime kreditore te subjekteve private apo shteterore.
- Nuk rezultojne detyrime ndaj shtetit.
- Nuk ka detyrime te taksave vendore.
- Nuk ka detyrime ndaj sig shoqerore apo shendetesore.
- Nuk ka detyrime ndaj subjekteve private.

Ne momentin e marrjes se vendimit per kalimin ne likuidim, pjesa e derdhur e kontributit te Ortakevetar prej 1.044.500 leke eshte perdorur per mbulimin e humbjes se krijuar ne vitet 2022-2024.

Per sa kam audituar te dhenat e Shoqerise konstatoj se

deri ne daten e likujdimit nuk ka detyrime ndaj Furnitoreve, Ortakeve, dhe Organeve Tatimore.

Shoqeria eshte ne gjendje dhe i ploteson te gjitha kushtet e procesit te likujdimit perfundimtar dhe çregjistrimin konform ligjit.

Ky raport u paraqit para Asamblese se Ortakeve te Shoqerise:

1. Z. Hekuran Brahimaj
2. Z. Sefer Selim Erdem,
3. Z. Fikret Bangu

me date 11.11.2024 te cilet e miratuan Raportin dhe Aktin perfundimtar te Likujdimit.

Tirane me, dt. 11.11.2024

Likujdatore

Minushe Xhafo

